



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU KUKËS
BASHKIA HAS
Njësia Administrative Golaj

PROJEKT PËRMIRËSIMI OSE KRIJIM KULLOTE

Fshati: Letaj
Zona kadastrale: 1832
Emri popullor i vendit: Rezervuari Letaj
Ekonomia Pyjore: Helshan
Ngastra/Nënngastra: 13c

PROJEKTUESI

KONTROLLOHET

(KONTROLLI NGA STRUKTURA E PYJEVE NË BASHKI)

MIRATOHET

(MIRATIMI NGA AGJENCIA KOMBETARE E PYJEVE)

JANAR 2025



KAPITULLI I

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1.1 Përmbledhje e projektit

Projekti do të zhvillohet në objektin në afërsi të rezervuarit Letaj me mbjellje direkt të farës së barit dhe do të aplikohet në një sipërfaqe prej **0.408 ha**. Ai përfshin aktivitete si: (i) Vlerësimi i tokës, ku përfshihet analizimi i kushteve aktuale të tokës dhe identifikimi i nevojave specifike për mbjellje; (ii) Zgjedhja e farave të barit, ku bëhet përcaktimi i specieve më të përshtatshme për klimën dhe tipin e tokës dhe përqindja që do të zerë secila prej tyre në përzjerje; (iii) Mbjellja direkte, nëpërmjet zbatimit të teknikave të mbjelljes për të siguruar një shpërndarje të njëtrajtshme të barit dhe mbrojtjen e farave nga dëmtuesit; (iv) Monitorimi dhe menaxhimi, nëpërmjet këtij aktiviteti bëhet vlerësimi i progresit pas mbjelljes dhe menaxhimi i kullotës për të siguruar rritje të shëndetshme dhe të qëndrueshme.

1.2 Qëllimi

Nëpërmjet këtij projekti synohet rehabilitimi i kullotës përmes mbjelljes direkte me farë bari, duke rritur cilësinë e përbërjes së vegjetacionit barishtor dhe optimizimin prodhimtarisë. Kjo metodë kontribuon në përmirësimin e strukturës së tokës, rritjen e diversitetit biologjik dhe reduktimin e erozionit, duke siguruar një habitat më të qëndrueshëm dhe burim më të mirë ushqimi për kafshët. Përmes mbjelljes direkte është e mundur të arrihet një riciklim i natyrshëm i burimeve dhe përmirësohet qëndrueshmëria e sistemit kullosor.

1.3 Objektivat Projektit

Objektivat e projektit janë si më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së kullotës në objekt: Rritja e përmbajtjes ushqyese dhe shëndetit të barit;
- Rritja e kapacitetit kullosor: Nëpërmjet mbulimit tërësor të sipërfaqes së objektit me bar, rritet prodhimtaria dhe numri mbajtës i kafshëve për kullotje;
- Pakësimi i erozionit: Bari nëpërmjet sistemit rrënjor ndihmon në stabilizimin e strukturës së tokës, zvogëlon forcën e rrymave të ujit dhe ato ajrore, duke minimizuar shkallën e humbjes së tokës;
- Shtimi i biodiversitetit: Inkurajohet zhvillimi i një biodiversiteti më të lartë në ekosistemet e kullotave;
- Rritja e qëndrueshmërisë: Bari absorbon lagështinë dhe ndihmon në ruajtjen e hidratimit të tokës, duke kontribuar në një ekosistem më të qëndrueshëm;
- Optimizimi i kostove: Zvogëlohen shpenzimet për plehërim dhe menaxhim të kullotave.



KAPITULLI II

2. TË DHËNAT E OBJEKTIT

2.1 Vendosja gjeografike dhe administrative

Objekti në të cilin do të ndërhyhet me mbjellje direkte fare barindodhet në vendin e quajtur Rezervuari Letaj dhe bën pjesë në ekonominë pyjore Helshan në zonën kadastrale 1832, në Nj. Admin. Golaj, Bashkia Has, me koordinatat gjeografike 42°17'40.84"N dhe 20°22'34.57"E.

2.2 Kufijtë Natyral

Objekti i planifikuar për mbjellje direkte kufizohet:

Nga veriu, kufizohet nga rezervuari i ujit Letaj

Nga jugu, kufizohet nga sipërfaqe me bimësi pyjore;

Nga lindja kufizohet nga sipërfaqe me bimësi pyjore;

Nga perëndimi kufizohet me sipërfaqe pyjore dushku.

2.3 Sipërfaqja

N/parcela me nr. 13c, Ekonomia pyjore Helshan ka një sipërfaqe prej 7.968 ha, e cila shfrytëzohet për kullotje gjatë periudhës gjithëvjetoje nga fermerët e zonës. Sipërfaqja ku do të aplikohet ndërhyrja me mbjellje bari direkt është 0.408 ha.

2.4 Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara

Objekti ndodhet pranë rrugës auto që lidh fshatrat Letaj dhe Peraj, të Nj. Adm. Golaj, Bashkia Has. Po ashtu ndodhet rreth 700 m pranë rrugës kryesore që lidh pikën kufitare të Qafë-Prushit me Krumën. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të rezervuarit të ujit Letaj. Distanca nga objekti ku do të bëhet përmirësimi i kullotës me qendrën e Nj. Ad. Golaj është rreth 7 km., nga qendra e Bashkisë Krumë, 16 km dhe fshati Letaj, 1 km.

2.5 Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia

Forma e rielievit është fundshpati me valëzime me pjerrësi maksimale 15%, me shkëmb amnor sedimentar.

2.6 Kundrejtimi

Objekti ka kundrejtim Verilindor.

2.7 Lartësia

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e objektit është 601 m, lartësia minimale 588 m, lartësia maksimale 613 m.



2.8 Rrjeti hidrografik

Rrjeti hidrografik përbëhet nga një numër përroskash që furnizohen me ujë vetëm gjatë sezonit të lagësht dhe rezervuari i ujit Letaj. Në pjesën veriperëndimore të objektit ndodhet një ligatinë me sipërfaqe rreth 0.4 ha ku burimet ujore janë aktive gjatë gjithë vitit.

2.9 Përbërja e bimësisë

Bimësia ekzistuese në zonën e projektit përfshin një tokë me bimësi të rrallë me prani të dëllinjës së kuqe (*Juniperus oxycedrus*), shkozës (*Carpinus orientalis*), ferrës (*Rubus ulmifolius*) dhe frashërit (*Fraxinus ornus*). Bimësia barishtore, kryesisht dominohet nga graminoret, nga llojet *Poa pratensis* dhe *Festuca pratensis* me shkallë mbulimi të territorit <20 dhe në pjesën ligatinore të kësaj zone gjendet edhe kulmaku.

2.10 Kushtet klimatike¹

Objekti ku do të kryhen punimet bën pjesë në klimën mesdhetare paramalore veriore. Ajo dallohet për verën e freskët dhe dimër të lagësht e të ftohtë më ngrica e dëborë.




Figura1.Grafiku i temperaturave mesatare mujore dhe vjetore

Temperatura mesatare vjetore arrinë 11.4 °C. Në shpërndarjen mujore të temperaturave vërehet se Janari është muaji më i ftohtë me vlera mesatare zakonisht -4°C deri 4°C. Temperaturat më të larta takohen gjatë muajit Korrik e Gusht, ku Korriku është muaji më i nxehtë me vlera mesatare të temperaturave 14 °C deri 28°C. Ditët me temperatura nën 0° C variojnë nga 20-30 ditë në vit.

Reshjet mesatare mujore dhe vjetore

Sasia vjetore e reshjeve varion nga 900 -1000 mm/vit. Sasi më e madhe e reshjeve është regjistruar gjatë periudhës Tetor - Mars në sasi mbi 600 mm. Sasi më e vogël e reshjeve është regjistruar gjatë muajit Korrik në sasi 28 mm. Në këtë zonë bien edhe reshje dëbore

¹<https://weatherspark.com/y/85651/Average-Weather-in-Krum%C3%AB-Albania-Year-Round#Figures-Rainfall>



që zakonisht zgjatin gjatë periudhës Nëntor – Mars, ku ditët me dëborë zgjatin rreth 30 ditë gjatë kësaj periudhe dhe reshjet e dëborës variojnë mesatarisht nga 25 mm deri 124 mm.




Figura2.Grafiku i reshjeve mesatare mujore dhe vjetore

2.11 Toka

Toka është e kafenjtë, nëntipi i kuqërremtë ose Calcaro-Chromic Cambisols sipas klasifikimit FAO (1974). Janë toka të maleve të ulëta të zonës së pyjeve të dushkut, të kondicionuara nga klima mesdhetare paramalore e malore. Formohen mbi produktet e alterimit (cipat e kuqërremta) të gëlqerorëve (në zonat me reshje të shumta dhe ndryshueshmëri klimatike midis dimrit dhe verës) dhe silikateve, kryesisht të konglomerateve dhe shtufëve ranorë. Kanë përbërje mekanike subargjilore të rëndë deri argjilore, strukturë kokrrizore granulare të paqëndrueshme dhe reaksion acid (pH nga 4 – 5.5). Janë toka të varfëra në fosfor të asimilueshëm për shkak të përmbajtjes së konsiderueshme të oksideve të hekurit dhe aluminit, fosfori kalon në formën e kripërave të patretshme.



KAPITULLI III

3. TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

3.1 Punimet që do të kryhen

3.1.1 Mbjellja direkte me farë bari

Mbjellja me farë e bimësisë barishtore të përshtatshme për kushtet e zonës është shumë e rëndësishme. Sugjerohet të përdoret vetëm në sipërfaqen e zhveshur të objektit rezervuari i Letaj në një sipërfaqe prej 4.08 dynym ose 0.408 ha. Prandaj, speciet duhet të zgjidhen në përputhje me kushtet stacionale dhe do të aplikohen në zona që kanë pjerrësi të vogël. Përzierja e farave që do të përdoret është përzgjedhur sipas kontekstit klimatik dhe aspektit të pjerrësisë së terrenit. Përbërja dhe sasia për metër katror është propozuar duke iu referuar mjedisit, klimës, nevojës për gjelbërim dhe formacionit gjeomorfologjik të tokës. Sasia e farave do të jetë 25 gr/m² dhe përzierja e farave për terrene sterile dhe të varfëra do të jetë:

45% *Lolium perenne*; 20% *Poa pratensis*; 35% *Medicago sativa*; 10% *Festuca pratensis*.

Origjina, mbirja e farave dhe përzierja e tyre me përbërësit e tjerë duhet të çertifikohet dhe përzierja duhet të bëhet në vendin e punës. Aplikimi konsiston në një shpërndarje të përzierjes në mënyrë të njëtrajtshme në një sipërfaqe prej 0.408 ha të objektit. Hedhja e farës duhet të aplikohet në stinët e lagështa (pranverë-vjeshtë) dhe kur toka ka jo shumë lagështi. Përpara hedhjes së farës së barit në zonë do të bëhet gërvishtja e sipërfaqes së tokës për të siguruar një kontakt më të mirë të farës së barit me shtresën e tokës në një thellësi 2-5 cm. Zakonisht sipërfaqja e mbjellë mund të konsiderohet e stabilizuar pas një viti nga momenti i mbjelljes. Është e nevojshme të kontrollohen sipërfaqet për të gjetur zonat ku mund të verifikohen defekte dhe nëse është e nevojshme duhet të riaplikohen brenda të njëjtit sezon.



KAPITULLI IV

4.1 Grafiku i punimeve

PP-1	Hedhja e farës së barit	Prill 2025 (5 puntore x 3.5 dite pune)
Objektivi 1	Përmirësimi i kullotës nëpërmjet mbjelljes direkt me farë bari në sipërfaqen prej 0.408 ha në objekt	1-4 Prill 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	1-4 Prill 2025
Detyrat	D.1.1 – Gërvishtja e tokës 2-5 cm thellësi D. 1.2 – Mbjellja e sipërfaqes me bar	1-4 Prill 2025
Rezultatet e pritshme	Zënia 100% e barit në 0.408 ha (gjatë muajit Prill)	4 Prill 2025

4.2 Shpenzimet për realizimin e projektit

Hequr nga dokumenti origjinal

4.3 Efektiviteti i ndërhyrjes

Përmirësimi i kullotës me mbjellje bari direkte me llojet *Lolium perenne*, *Poa pratensis*, *Medicago sativa* dhe *Festuca pratensis* jep disa përfitime të mundshme, të cilat po i rendisim më poshtë:

- Diversiteti i Ushqimit. Kombinimi i këtyre llojeve ofron një dietë të pasur për bagëtinë, duke siguruar lëndë ushqyese të plota;
- Qëndrueshmëri. *Poa pratensis* dhe *Festuca pratensis* janë të njohura për qëndrueshmërinë e tyre në kushte të ndryshme klimaterike, duke e bërë kullotën më të qëndrueshme;
- Rritja e Produktivitetit. *Medicago sativa* rrit prodhimin e proteinave dhe ndihmon në përmirësimin e tokës përmes akumulimit të azotit në tokë;
- Mbrojtja e Tokës. Këto lloje kontribuojnë në parandalimin e erozionit dhe ruajnë strukturën e tokës;
- Rritja e Qëndrueshmërisë Ekologjike. Diversiteti ndihmon në ruajtjen e biodiversitetit dhe shëndetit të përgjithshëm të ekosistemit;
- Kursim i Kostove. Një kullotë më e pasur ul kostot për ushqimin e bagëtive, duke rritur përfitimet ekonomike.

Një pjesë e informacionit është hequr nga dokumenti origjinal

4.4 Kuotimi për bazën materiale

Hequr nga dokumenti origjinal



4.5 Analiza e riskut

Aktivitetet	Rreziku identifikuar	Propabiliteti që të ndodhë (U/M/L)	Impakti Riskut (U/M/L)	Masat për zbutjen	Masa shtesë
Mbjellja direkt me farë bari	Cilësia e farës së barit	M	L	Kontrolli i certifikatës së cilësisë dhe ndjekja e punimeve me korrektësi sipas projektit.	
	Mungesa e gërvishtjes së tokës sipas parashikimit të projektit	M	L		
	Mënyra hedhjes së farës së barit	M	M		
	Kushtet ekstreme të motit (ngricat)	L	L	Njohja paraprake me kushtet e motit	
				Ndalimi punimeve kur moti është i papërshtatshëm	
	Kullotja e bagëtive	L	L	Ruajtja e objektit	
				Komunikimi me barinjtë	
				Mundësi për sigurimin alternativ të bazës ushqimore	



KAPITULLI V

ANEKSE

- Foto dixhitale të vendit ku do të realizohen punimet.






- Planimetria e objektit dhe koordinatat gjeografike




Pika e poligonit	X (V)	Y (L)
1	42°17'41.31"	20°22'35.55"
2	42°17'41.13"	20°22'36.34"
3	42°17'40.87"	20°22'36.89"
4	42°17'40.44"	20°22'37.28"
5	42°17'39.66"	20°22'37.48"
6	42°17'39.41"	20°22'36.64"
7	42°17'39.73"	20°22'35.82"
8	42°17'39.75"	20°22'34.72"
9	42°17'39.60"	20°22'33.96"
10	42°17'39.53"	20°22'33.34"
11	42°17'39.80"	20°22'33.01"
12	42°17'40.09"	20°22'33.30"
13	42°17'40.43"	20°22'33.20"
14	42°17'40.64"	20°22'33.39"
15	42°17'40.75"	20°22'33.85"
16	42°17'40.95"	20°22'34.35"
17	42°17'41.02"	20°22'34.68"
18	42°17'41.22"	20°22'35.05"



- Harta e Ekonomisë Pyjore dhe planimetria e parcelës



Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
Shtator 2021



Objekti ku do të ndërhyhet me mbjellje direkt fare bari



megateksa.com/sq/fare-bari-bavicchi-kuti-1-kg-25-40-m2-per-sport-rezistence-shume-e-larte-ndaj-shkeljes

GoogleOversattESF | SUNV ESF | PIGment IdentityEncyclopedia of the...EUFORGENPlants of the WorldSekretaria MasmoreConfers

X

Google Chrome isn't your default browserSet as default

PRODUKTETKerkoShporta ime

Farë bari, Bavicchi, kuti/1 kg 25-40 m2, per sport,
rezistencë shumë e lartë ndaj shkeljes

Kodi: 332858

1,390 Lekë

Copë (1 Copë)

- 1 +

Shto në sipërfaqe të preferuarveShto te KrahshimetPrinto faqen

Sipërdaj:

Përshkrim i detajuarSpecifikime teknike

Një linjë produktesh të marra nga përzierja e cilësive më të mira të farëve për të përbushur të gjitha nevojat e kopstherive tuaja, sepse çdo mjedis ka karakteristika specifike që ne duam të jemi të kënaqur për ta bërë atë një vend unik dhe prestigjioz. Përzierje e re për zbkunese dhe sportive, rezistenca shumë e lartë ndaj shkeljes falë zhvillimit horizontal të peribetësve të saj të cilët biennda disa muajve të mijëllojës ndërtojnë një strukturë të dendur të barit shumë rezistent. Të ngjitet përjetësh janë me tolerancë ndaj hijeve (deri në 75%) dhe në temperaturë të ujit; kjo e bën Rugby Grass përzierjen ideale edhe për zonat me hije. Mund të shkurohet shpesht, edhe në lartësi shumë të ulët, të shpejtë në shtetje pranvere, të ngadalta për të hyrë në gjumë dimëror, gjithashtu i përkrahshëm për klimat e mëtha për sa kohë me ujëte. Përzierja Lolium Perenne 18.6%, Festuca R. Rubra 20.1%, Poa Pratensis 44.6%, Poa Supina 16.7%



Subjekti Juridik "Xhepi sh.p.k"

Nipti:K84509202A

Adresa: Durrës Fushe Krujë, Krujë, Njesia Bashkiake Fushe Krujë ,Fshati Halil Zona
Kadastrale 1665,nr.Pas.213/41. Rruga e Rozmairna. 1502

Oferte

Nr.	Emertimi I llojeve pyjore te zgjedhur per pyllezim	Sasia (cope)	Cmimi per njesi me tvsh (euro)	Vlera (euro)
1	Qarr 2-vjecar	1998	2.0	3996
2	Lajthi e bute 2-vjecare	1206	2.4	2894.4
3	Pishe e zeze 2-vjecare	2743	0.8	2194.4
4	Plep I zi 2-vjecar	1751	2.0	3502
5	Geshtenje e bute 2-vjecare	876	2.4	2102.4
6	Bli fletegjere	467	1.6	747.2
7	Pleh kimik (DAP)	8.214 Kv	120	985.68
Totali				16.422

Duke iu falenderuar per mirekuptimin

Subjekti "Xhepi sh.p.k"

Administratori

Nuri Xhepi



Nuri Xhepi
[Signature]